

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit H. F. nga fshati R., Komuna e P., për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijes kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 Kodi Penal i Republikës së Kosovës në (tekstin e metutjeshme KPRK-se) sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP. II.nr.1266/16, të datës 14.07.2016, më datën 03.10.2016, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

H. F. nga i ati F. dhe e ema M., e gjinis R. i lindur më ..., me vendbanim në fshatin R., Komuna e P., ku edhe jeton , i pa pune, i pamartuar, me shkolle të mesme të kryer, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Serbisë.

Është fajtor

Me datën ..., në ora ... minuta, në fshatin K. të Komunes së Gj., ka kaluar kufirinnga Republika e Sërbisë në Republikën e Kosovës, në vendin i cili nuk ishte vendkalim i autorizuar kufitar, në atë mënyrë që me automjetin e tij të markës " ..." me ngjyrë të ... dhe targa të regjistrimit ... niset nga fshati R. i Komunes së P. së RS dhe duke shfrytëzuar rrugën ilegale hynë në fshatin K. të komunes së Gj. të RK ku dhe qëndron dhe kthehet pa u hetuar, mirpo disa dite më vonë i njëjti hetohet duke hyre në SPK- M., ndalet prej patrullës së policisë kufitare të Kosovës dhe për të njëjtin raportohet tek organet kompetente.

- me këtë ka kryer veprën penale kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 164 paragrafi 1 të KPRK-se.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 39 dhe 64 të KPK, si dhe neni 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit H. F. i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **250 € (dyqinde e pese dhjete Euro)**, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në

punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris perfundimtare të kësaj gjykate dhe në emër të paushallit gjyqësor ne shumen prej 20 euro në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit H. F. nga fshati R., Komuna e P. për shkak të veprës penale kalim i paautorizuar i bendkalimeve ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 të KPRK. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit H. F. dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, fotografive që gjenden në shkresa të lëndës, raporteve policore, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri H. F. ka kryer veprën penale kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 164 paragrafi 1 të KPRK-se. , vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 i KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Më 03.10.2016

**Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi**

**Gjyqtari,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.